

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.

**Pasqyrat financiare individuale
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(dhe Raportin e Audituesve të Pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtje

Rapori i audituesve të pavarur.....	i-iii
Pasqyra individuale e pozicionit financiar.....	1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra individuale e flukseve monetare.	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare.....	5 – 39
Raporte plotësuese.....	I-II

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Sigal Uniqa Group Austria sh.a,

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Sigal Uniqa Group Austria sh.a (“Shoqëria”), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat individuale financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabel më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të Tjera

Pasqyrat financiare individuale të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 u audituan nga një auditues tjetër i cili shprehu një opinion pa rezervë mbi ato pasqyra financiare individuale më 30 prill 2019.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomaliave materiale në pasqyrat financiare individuale, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- Marrim evidencë të mjaftueshme të auditimit të duhur në lidhje me informacionin financiar të njësisë ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Shoqërisë për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare individuale. Ne jemi përgjegjës për kryerjen e auditimit të Shoqërisë. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.


Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare Aktivitet në Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit dhe Mjaftueshmërinë e Kapitalit, ("Anekse Shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare. Informacioni historik financiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2019, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
31 maj 2020

Mediana Kodra, FCA
Kod



SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e pozicionit financiar
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktive			
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	9	84,588	96,075
Depozita me afat me bankat	10	3,847,055	3,439,499
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi	11	572,177	550,666
Tatim fitimi i arkëtueshëm	29	30,177	54,698
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	12	336,853	314,856
Llogari të arkëtueshme nga risigurimi	13	2,073,544	795,280
Investime në filiale	14	2,223,050	2,223,050
Aktive afatgjata materiale	15	1,027,725	728,768
Aktive të tjera	16	160,187	148,660
Totali i aktiveve		10,355,356	8,351,552
Detyrime			
Rezerva për dëme	17	3,745,478	2,291,878
Rezerva për primet e pafituara	18	2,193,911	1,992,179
Detyrime të tjera	19	783,554	427,435
Totali i detyrimeve		6,722,943	4,711,492
Kapitali			
Kapitali aksionar	20	2,232,909	2,232,909
Rezerva të rrezikut të sigurimit	21	262,225	262,225
Fitimi i mbartur		1,137,279	1,144,926
Totali i kapitalit		3,632,413	3,640,060
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		10,355,356	8,351,552

Këto pasqyra financiare individuale janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Shoqërisë më 29 maj 2020 dhe janë firmosur nga:

Avni Ponari
 Drejtor i përgjithshëm

Klement Mersini
 Drejtor Finance



SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Prime të shkruara bruto	22	4,293,007	4,113,160
Ndryshimi në rezervat e primeve të pafituara	18	(201,732)	(15,599)
Primet bruto te fituara		4,091,275	4,097,561
Prime të ceduara në risigurim	23	(677,803)	(642,144)
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituara	18	111,464	(88,187)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		3,524,936	3,367,230
Të ardhura të tjera	24	60,275	94,535
Të ardhura neto		3,585,211	3,461,765
Ndryshimi në rezervat e dëmeve të sigurimit	17	(1,453,600)	(130,321)
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit ne rezervën e dëmeve	17	1,166,799	(11,941)
Dëme të paguara	17	(1,934,737)	(1,149,307)
Dëme të paguara të risiguruara	17	628,482	8,421
Dëme të sigurimit neto		(1,593,056)	(1,283,148)
Kostot e marrjes në sigurim	25	(681,589)	(628,357)
Shpenzime administrative	26	(991,238)	(1,123,026)
Shpenzime të tjera sigurimi	27	(263,882)	(293,526)
Fitimi operativ		55,446	133,708
Të ardhura nga investimet	28	134,281	197,776
Humbje nga kursi i këmbimit		(25,845)	(126,530)
		108,436	71,246
Fitimi para tatimit		163,882	204,954
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	29	(31,529)	(20,058)
Fitimi i vitit		132,353	184,896
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		132,353	184,896

Shënimet nga faqja 5 në 39 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Kapitali aksionar	Rezerva të rrezikut të sigurimit	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2018	2,232,909	262,225	1,121,030	3,616,164
Fitimi i vitit	-	-	184,896	184,896
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	184,896	184,896
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Dividendë të paguar	-	-	(161,000)	(161,000)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	(161,000)	(161,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,232,909	262,225	1,144,926	3,640,060
Gjendja më 1 janar 2019	2,232,909	262,225	1,144,926	3,640,060
Fitimi i vitit	-	-	132,353	132,353
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	132,353	132,353
Transaksione me pronarët e Shoqërisë				
Dividendë të paguar	-	-	(140,000)	(140,000)
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	-	-	(140,000)	(140,000)
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,232,909	262,225	1,137,279	3,632,413

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a.
Pasqyra individuale e flukseve monetare
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Flukset monetare nga veprimtaritë operative			
Fitimi i vitit		132,352	184,896
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	15	45,247	43,349
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale		3,512	2,379
Të ardhura nga interesi	28	(11,010)	(25,561)
Të ardhura nga dividendët	28	(135,792)	(172,215)
Zhvierësime të llogarive të arkëtueshme nga sigurimi	11	66,495	64,704
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	29	31,529	20,058
Flukset monetare nga veprimtaritë operative para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		132,333	117,610
Ndryshime ne:			
— llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi		(1,278,264)	100,129
— llogaritë e arkëtueshme nga sigurimi		(88,006)	(186,888)
— kostot e shtyra të marrjes në sigurim		(21,997)	(46,249)
— aktivet e tjera		(11,527)	10,774
— rezervat për dëme		1,453,600	130,321
— rezervat për primet e pafituara		201,732	15,599
— detyrimet dhe provizionet e tjera		114,051	(66,722)
Mjetet monetare të gjeneruara nga veprimtaritë operative para interesit dhe tatimit		501,922	74,574
Tatimi fitimi i paguar		(7,008)	(34,143)
Interesa të arkëtuara		14,656	24,572
Flukset monetare neto nga veprimtaritë operative		509,570	65,003
Flukset monetare nga veprimtaritë investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	15	(105,647)	(74,754)
Investime në depozita me afat		(411,202)	(21,691)
Dividend të arkëtuara	28	135,792	172,215
Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë investuese		(381,057)	75,770
Flukset monetare nga veprimtaritë financuese			
Dividend të paguar		(140,000)	(161,000)
Flukset monetare neto të përdorura në veprimtaritë financuese		(140,000)	(161,000)
Pakësim neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre		(11,487)	(20,227)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit		96,075	116,302
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit	9	84,588	96,075

Shënimet nga faqja 5 në 39 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare individuale.